

Fejton: “Shpërbërja e Jugosllavisë” (13)

Pakënaqësi nga Triglavi deri në Vardar

Serbët e Kosovës, të përkrahur nga kisha ortodokse, kërkonin nga Beogradi mbrojtjen e tyre nga shqiptarët. Në televizionin e Beogradit paraqiteshin gra që tregonin “hjekat” e tyre në duart e dhunuesve shqiptarë. Me këtë atmosferë të krijuar, Serbia po i tregonte synimet e saj

Vitet tetëdhjetë kishin shumëçka në barrë. Titoja kishte vdekur. Në prill të vitit 1981 kishin shpërthyer demonstratat e shqiptarëve në Kosovë. Kisha ortodokse serbe në Serbi dhe ajo katolike në Kroaci kishin nisur të merrnin një rol të ri. Boris Kraigher dhe Tihomir Vlashkaliq kishin marrë përsipër të studionin sistemin ekonomik dhe politik. Pakënaqësi kishte që nga Triglavi deri në Vardar. Sllovenët nuk ishin të kënaqur që duhej të paguanin taksa edhe për rajonet e pazhvilluara brenda Jugosllavisë. Shqiptarët ankoheshin për papunësinë që i kishte kapluar. Serbët ishin të shqetësuar për zgjerimin e federatës dhe kroatët me idenë e tyre për pranverën kroate. Në Mal të Zi njerëzit janë ngritur në protesta dhe i kanë thyer dyqanet në Titograd (tani Podgoricë), kur e kanë kuptuar se u ishte shitur detergjent

fals. Popullata nisi të kishte dyshime të hapura ndaj sistemit të vetëqeverisjes.

Ndërkohë, serbët e Kosovës shkonin në Beograd për të kërkuar nga udhëheqësit politikë mbrojtje nga shqiptarët. Kisha ortodokse serbe nxiti madje edhe petition duke kërkuar mbrojtjen e serbëve të Kosovës dhe trashëgimi-nië e tyre të shenjtë. Akademia e Shkencave e Serbisë e nxori memorandumin që tronditi gjithë Jugosllavinë. Historianët serbë nisën të ndryshonin fjalët për historinë, duke thënë se Drazha Mihajloviq nuk kishte qenë në të vërtetë aq i keq për popujt e tjerë, të cilët i kishte masakruar. Televizionet e Serbisë nxirrnin pamjet e grave serbe që tregonin se si qenkëshkin dhunuar nga shqiptarët gjakatarë.

E gjithë kjo i tregonte synimet e Serbisë. Mungonte vetëm lideri. Ishin dy kandidatë. I pari ishte



Sipas legjendës, car Lazari para Betejës së Kosovës paska parë ëndërr që po e humbiste betejën për të fituar një mbretëri në amshim. Për serbët Kosova u bë kjo mbretëria hyjnore. Mungonte vetëm mbreti. Shkrimtari Dobrica Qosiq dhe politikanin i ri Slobodan Milosheviq ishin kandidatë për ta marrë fronin

shkrimtari Dobrica Qosiq, romani i të cilit “Koha e vdekjes” ishte bërë e adhuruar nga publiku. I dyti ishte Slobodan Milosheviq, një politikan i ri e ambicioz. Lideri duhej të ishte si në legjendat serbe për car Lazarin. Sipas këtyre legjendave, para Betejës së Kosovës më 1389, car Lazari, udhëheqësi i ushtrisë serbe, e kishte parë një ëndërr. Në atë ëndërr, sipas këtyre rrëfimeve, një

egjëll i ishte shfaqur duke i bërë ofertë: ja ta fitonte betejën kundër turqve e të bënte një mbretëri të fortë në qiell, ja ta humbiste betejën, të vdiste si dëshmor dhe ta fitonte mbretëri të fortë në qiell. Car Lazari e paska zgjedhur këtë të dytën.

Për serbët Kosova ishte diçka e këtillë - një mbretëri hyjnore. Vetëm se pritej se kush do të jetë car Lazari i riinkarnuar. Slobodan

“Shpërbërja e Jugosllavisë” është raport i përpiluar nga projekti “Iniciativa e intelektualëve”, rreth të cilit janë mbledhur historianë të shumtë nga Ballkani dhe mbarë bota për të hulumtuar gjenezën e konfliktit në ish-Jugosllavi. Ky projekt ka punuar në disa grupe të ndara, të cilat kanë trajtuar aspekte të ndryshme dhe kanë përpiluar raporte të veçanta. Grupi që ka punuar raportin rreth “Shpërbërjes së Jugosllavisë” është udhëhequr nga Sabrina Ramet dhe Latinka Perović. Për shkak të hapësirës, “Koha Ditore” e boton si fejton një variant të shkurtuar të raportit.

Milosheviqi ende nuk kishte karizmë të një lideri.

(Në numrin e nesërm: Si u ngrit Milosheviqi në Fushë-Kosovë? Çka thoshte Ivan Stamboliqi për Milosheviqin? Si ndryshoi Milosheviqi nga një politikan në një të shenjtë?)

Fejton: “Sekretet e spiunazhit botëror” (13)

Të spiunosh nga distanca

Parapsikologët qëndronin në një qytet dhe që atje përpiqeshin që në mendje të shihnin se çka ndodhte në një qytet tjetër. Për vite të tëra ata ishin një armë e rëndësishme e spiunazhit në SHBA

Ai quhej Joseph McMoneagle, por për qëllimet e njërive të psikologjisë në zbulimin e armatës amerikane ai njihej me shifrën Vëzhguesi teledirigjues numër 1. Një ditë vjeshte në vitin 1979 ai ishte i ulur në një zyrë me dritë të dobët karshi një agjenti që e mer-te në pyetje. Për njëzet minuta McMoneagle kishte qenë në një gjendje të meditimit të thellë dhe më pas, siç thotë vetë kishte “hapur mendjen”. Në mendje kishte parë disa ndërtesa pa dritare, tym që dilte në largësi, pastaj kishte njuatur një aromë të çuditshme, si një përzierje e

squfurit dhe e gazit natyror. Thuase ishte një shkritore aty afër. Të gjitha ato që i kishte parë në mendje, i kishte vizatuar në një copë letër. Një tjetër vëzhgues teledirigjues, ai numër 29, kishte parë edhe gypa.


Që nga vëzhguesi numër një deri te ai 29 kishin qenë - pa e ditur ata vetë - pjesë të një eksperimenti të CIA-s që ka vazhduar nga viti 1972 deri më 1996. Në këtë program eksperimentues ishin shikuar disa fenomene parapsikologjike, përfshirë edhe atë që njihej si “vëzhgimi me teledirigjim”. Vëzhgimi me

teledirigjim ishte një gjendje, në të cilën një person që gjendej në një qytet, mundahej të shikonte se çka po ngjante në një qytet tjetër. CIA nëpërmjet parapsikologëve ka tentuar të vëzhgojë vendet e armëve nukleare në botë, ta rregullojë krizën e pengjeve në Iran, të vëzhgojë Gadhaffin në Tripoli dhe gjëra të tjera. Programi ka qenë i njohur me emrin “Stargate”.

Ç’është e vërteta në SHBA, CIA që nga vitet pesëdhjetë ka bërë eksperimente psikologjike dhe psikiatrike në shërbim të spiunazhit. Ngjashëm ka vepruar edhe KGB-ja në ish-BRSS. Më se 73.000 faqe dokumente janë mbajtur me vulën sekret deri vitin e kaluar, kur janë hapur për publik. Më 1972, CIA kishte nisur që nëpërmjet parapsikologëve “të vëzhgonte” BRSS-në në hapësirën e Kazakistanit të sotëm. CIA e ka financuar projektin deri më 1975, ndërsa më pas projekti është financuar nga burime të tjera brenda sektorit amerikan të Mbrojtjes. Vetëm gjatë periudhës 1979 - 1994, janë vëzhguar mijëra misione të ndryshme. Më 1987, bëhej një përpjekje për ta gjetur tradhtarin në radhët e CIA-s. Parapsikologu doli me përfundimin: është një person që jeton në periferi të Washingtonit, që nget një veturë luksoze të huaj, mbase me ngjyrë të hirtë, që ka një dashnore nga Amerika Latine - mbase, nga Kolumbia. U zbulua se tradhtari kishte qenë Aldrich

Ames. Të gjitha lidheshin pos ngjyrës së veturës së tij. Ai ngiste “Jaguar” të kuq.

Mirëpo, programi i vëzhgimeve me teledirigjim u ndërpre në mesin e viteve nëntëdhjetë, kur tashmë kishte mbaruar Lufta e Ftohtë. Urdhrin për ndërprerje e kishte dhënë drejtori i CIA-s, John Deutch, dora vetë. Programi kishte kushtuar 20 milionë dollarë. CIA thotë se nuk e përdor më fare këtë metodë. Ushtria amerikane as nuk e pohon as nuk



e pohon nëse e përdor parapsikologjinë për nevoja të veta.

(Në numrin e nesërm: Cilët ishin spiunët e heshtur të Moskës në New York? Si funksiononte martesja e spiunëve? Cili ishte gjykimi më i madh dhe më kundërtshënës i spiunëve në SHBA?)

Mbretër të tradhtisë

Spiunazhi për vendin tënd quhet patriotizëm. Spiunazhi kundër vendit tënd quhet tradhti. Dy agjentë sekretë amerikanë, Robert Hanssen dhe Aldrich Ames, kanë qenë ndër tradhtarët më të mëdhenj të Amerikës në kohën e Luftës së Ftohtë. Ames dhe Hanssen i kanë tradhtuar gati të gjithë spiunët e dyfishtë që CIA donte t’i shfrytëzonte kundër sovjetëve. Vendet ku presidentët amerikanë do të strehoheshin në rast krize, tunelet e fshehta nën Ambasadën sovjetike në Washington, vlerësimet amerikane për fuqinë e raketave sovjetike - të gjitha këto ishin zbuluar nga këta dy njerëz. Ames kishte fituar 2,7 milionë dollarë nga rusët dhe i priste edhe 1,9 milionë të tjera në konton e tij. Kjo është shuma më e madhe që e ka marrë ndonjëherë ndonjë spiun. Hansseni, ndërkaq, është paguar vetëm 600.000 dollarë. Mirëpo, cili ka qenë dëmi i shkaktuar? Më se dhjetë persona janë vvarë sherri i këtyre dy njerëzve - pa llogaritur dëme të tjera. Të dy janë paraqitur vullnetarisht më 1985 për të punuar për KGB-në. Hansseni shfaqej si katolik i devotshëm, por ndërkohë shumicën e parave i shpenzonte me një striptizetë, me të cilën nuk çonte dashuri, por vetëm bisedonte. Ishte njeri shumë i luajtur. E kishte fotografuar gruan e vet lakuriqe dhe fotografitë e saj i kishte dërguar në sajte interneti. Ames i bënte jetë pasaniku. Të dy janë arrestuar dhe janë dënuar me burgim të përjetshëm.

